

RECENSION

**PËR VLERËSIMIN E TEZËS SË DOKTORATURËS TË KANDIDATIT
FAIK IDRIZI**

**NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE TË
FAKULTETIT FILOLOGJIK, UNIVERSITETI I TETOVËS**

Deri te:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOLOGJIK

Në bazë të Vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik, në mbështetje të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve - studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filologjik në mbledhjen e mbajtur më 15.05.2024, solli Vendim për formimin e komisionit vlerësues të tezës së doktoraturës së kandidatit Faik Idrizi në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane me nr. 18-303/2 të datës 16.05.2024, në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Gjuliano Iseini - kryetar**
- 2. Prof. Dr. Suzana Ejupi - anëtar**
- 3. Prof. Dr. Arbër Çeliku - anëtar**
- 4. Prof. Dr. Berton Sulejmani - anëtar**
- 5. Doc. Dr. Shadan Ramadani - anëtar**

Komisioni vlerësues duke qenë falënderues për besimin e dhënë, ka nderin të paraqesë këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e tezës së doktoraturës të kandidatit Faik Idrizi me temë: *Foljet me parashtesë të gjermanishtes (Präfixverben) dhe mundësitë e realizimit të tyre tekstor në gjuhën shqipe*

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati Faik Idrizi i lindur më 04.02.1978 në Forinë të Gostivarit, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollimin fillor dhe të mesëm i ka kryer në Gostivar. Studimet deridiplomike i ka kryer në Universitetin Shtetëror të Tetovës, programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane. Studimet pasdiplomike (magjistraturë) i ka kryer në Universitetin e Tetovës, programi studimor Gjuhë Gjermane.

Për hulumtime të specializuara ka qëndruar në Universitetin e Vjenës, Republika e Austrisë dhe në Universitetin e Mannheim-it, Republika e Gjermanisë në vitin 2016.

Nga viti akademik 2011/2012 deri më sot është i angazhuar si asistent part-time në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Fakulteti Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Me hapjen e studimeve të doktoraturës për herë të parë në Universitetin e Tetovës në vitin akademik 2015/2016, duke marr parasysh interesin dhe dëshirën e zjarrtë për thellimin e njohurive të tij në fushën e gjuhësisë, regjistrohet në studimet e doktoraturës në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, i vetmi program i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, në konsultim me mentorin e akredituar, Prof. Dr. Arbër Çeliku, për zgjedh temën sa aktuale aq edhe sfiduese: *Foljet me parashtesë të gjermanishtes (Präfixverben) dhe mundësitë e realizimit të tyre tekstor në gjuhën shqipe*.

Gjatë gjashtë semestrave ai i ka dhënë të gjitha provimet e parapara me Rregulloren e studimeve të doktoraturës dhe programin e akredituar të shkollës doktrale me sukses të shkëlqyeshëm.

Po ashtu me sukses i ka përmbyllur të tria konferencat doktrale, të parapara me Rregulloren e studimeve të doktoraturës.

Ka publikuar këto punime shkencore ndërkombëtare:

THE REALISATION OF TEXT COHERENCE THROUGH CONCEPTUAL METAPHORS IN THE ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE

South Florida Journal of Development, Miami, vol. 5, no. 4. ISSN 2675-5459.

VERB DERIVATION WITH THE PREFIX VER- IN GERMAN AND THE POSSIBILITIES OF THEIR TEXTUAL REALISATION IN ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE

5th INTERNATIONAL CONGRESS ON CONTEMPORARY SCIENTIFIC RESEARCH / Kayseri, Türkiye.

ALBANIAN AND TURKISH – THE LANGUAGE, CULTURAL AND HISTORICAL CONSTELLATIONS FROM THE PAST TILL NOWADAYS

EL RUHA 11th INTERNATIONAL CONFERENCE ON SCIENTIFIC RESEARCH / Şanlıurfa, Türkiye.

Vlerësimi i tezës së doktoraturës së kandidatit Faik Idrizi

Teza e doktoraturës e kandidatit Faik Idrizi i plotëson si kushtet formale-juridike në bazë të Rregullores së studimeve të doktoraturës të Universitetit të Tetovës, po ashtu edhe ato përmbajtësore. Ajo është e shkruar në 160 faqe, me një rrjedhshmëri gjuhësore dhe stilistike në nivelin e duhur, strukturimi i krerëve është i qartë dhe zhvillohet në dy linja: teorike dhe empirike, kurse burimet janë në numër të madh dhe dëshmojnë për autencitetin e hulumtimit në fjalë, që nënkupton se kandidati ka dëshmuar për një pjekuri hulumtuese-shkencore.

Poashtu, punimi është verifikuar edhe në sistemin për plagjiaturë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tematika në fjalë është e një rëndësie të veçanti, sidomos për fushën e gjuhësisë krahasuese, me theks të veçantë asaj kontrastive midis gjermanishtes dhe shqipes, duke sjell një kontribut të çmueshëm në arealin gjuhësor edhe albanologjik, meqë ka pak studime sa i përket problematikës së fjalëformimit të foljet me parashtesa të shqipes krahasuar me gjuhën gjermane.

Kandidatit ia ka dal me sukses ta shtjelloj problemin e fjalëformimit të foljes me parashtesa parafjalore, duke i analizuar dhe hulumtuar ato në tërësi dhe duke krijuar një korpus të të gjitha foljeve me parashtesë të gjermanishtes në formën e një fjalorthi, krahasuar me shqipen.

Në kreun hyrës janë formuluar mjaft qartë hapat e ndërmarra për realizimin me sukses të këtij punimi të doktoraturës.

Qysh në fillim të punimit jepet një arsytim i duhur i temës:

Sa i përket fjalëformimit të foljes në gjermanishte, ai është tepër produktiv, në kuptimin që një lekseme të caktuar foljore mund t'i shtohen parashtesa të caktuara dhe të fitohen fjalë të reja me kuptime të ndryshme. Po ta marrim foljen *ziehen*, kuptimi origjinar i së cilës është *tërheq*, dhe asaj i shtojmë parashtesa (të ndashme dhe të pandashme) si *be-*, *ein-*, *aus-*, *an-*, *um-*, etj, përfitojmë fjalë të reja me kuptime të reja: *beziehen* nënkupton *i referohem diçkaje apo dikujt*, *einziehen* - *mblodh*, *koleksionoj*, *anziehen* - *vishem*, *ausziehen* - *zhvishem*, *umziehen* - *ndërroj teshat*, dhe kështu me rradhë.

Jo se në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë referentët përkatës, por është e pamundur të realizohen ato përmes parashtesave si në gjuhën gjermane. Edhe në gjuhën shqipe ekzistojnë folje me parashtesa, por në gjuhën gjermane ky proces është mjaft produktiv dhe shpeshherë është mjaft lajthitës dhe stërmundues për të gjithë ata, të cilët dëshirojnë ta mësojnë gjuhën gjermane.

Boshti tematik i këtij punimi do të jenë foljet e këtilla të gjermanishtes, të cilat janë produktive për përfitimin e parashtesave, duke i trajtuar ato në aspektin e formimit, funksionit dhe përvetësimit nga shqiptarët të interesuar për mësimin e gjermanishtes. Secila do të krahasohet veç e veç me referentët përkatës në gjuhën shqipe dhe në pah do të nxirren rastet ku ato nuk përkojnë ose përkojnë në mënyrë të pjesshme me leksemat e caktuara në gjuhën shqipe, që të mund të krijohet një inventar i caktuar e përmbledhës i këtyre foljeve me referentët e tyre përkatës në gjuhën shqipe, në formën e një fjalorthi.

Duke u bazuar në parametrat e sipërpërmendura, shtrohen jepen qëllimet si në vijim:

Qëllimi kryesor i këtij punimi fillimisht është të ndërtohet një kornizë e mirëfilltë teorike mbi tematikën në fjalë, që më pas përmes teksteve konkrete të arrihet në rezultate të konsiderueshme sa i përket shtjellimit të foljeve me parashtesa në gjermanishte në aspektin morfo-sintaksor, semantik dhe pragmatikor, si dhe mundësisë së tyre të rimarrjes në gjuhën shqipe, që të lehtësohet ndërtimi, funksioni dhe kuptimi i tyre gjatë mësimin të gjuhës gjermane nga ana e të rinjve shqiptarë.

Më tej në punim shtrohen këto pyetje hulumtuese, të cilave kjo tezë doktrature synon t'u përgjigjet:

- Sa ndikon njohja e thelluar e foljeve me parashtesë të gjermanishtes në procesin e të kuptuarit të tyre gjatë mësimnxënies?
- Çfarë roli luan konteksti në mësimin dhe përvetësimin e tyre në gjuhën e huaj?
- Sa ndikon mësimdhënësi në procesin e mësimin dhe përvetësimin të tyre?
- Cilat probleme hasen gjatë përkthimit të foljeve me parashtesa nga gjuha amtare në gjuhën e huaj?
- A i shmangen nxënësit mësimin të foljeve me parashtesa në gjuhën e huaj për shkak të kompleksitetit kuptimor që kanë ato?

Edhe hipotezat e ngritura janë filluar me përpikëri shkencore, gjë që dëshmon për një qasje serioze hulumtuese-shkencore:

Natyrisht se secili studim ndërtohet, paraprakisht duke ngritur çështje problemore për një tematikë të caktuar. Në rastin konkret, për të analizuar foljet me parashtesa të gjermanishtes, është dashur të mendohen mirë hipotezat që do të ngrihen, me qëllim që punimi të dalë sa më i plotë dhe i qartë. Hipotezat e ngritura janë këto:

- a) Do të konstatohen ngjashmëritë dhe dallimet morfo-sintaksore dhe semantike në të dyja gjuhët, gjermanishtes dhe shqipes,
- b) Do të jepen rekomandime për përdorimin e saktë të këtyre strukturave për qëllime komunikuese,
- c) Do të jepen rekomandime edhe për përkthimin e tyre konsekuent, duke marr parasysh kontekstin dhe kontekstin jashtëgjuhësor,
- d) Do të analizohen planet dhe programet mësimore ekzistuese të trajtimit të foljeve me parashtesa në tekstet universitare të gjermanishtes si gjuhë e huaj,
- e) Do të tematizohet rëndësia e mësimin të foljeve me parashtesa gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Evident është edhe korpusi i dendur metodologjik, i cili konsiston në metodat e përdorura si në vijim:

- Metodave deskriptive, kanë një rëndësi të veçantë për përshkrimin e mbarë procesit të zhvillimit gjuhësor dhe rolin e gjuhës së rrethanat e sotme.
- Metoda e deduksionit, e cila ka një rëndësi të veçantë në trajtimin e problematikës në fjalë nga e përgjithshmja tek e veçanta.

- Metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, e cila do të jetë me rëndësi të veçantë në arritjen e rezultateve konkrete praktike.
- Metoda krahasuese, e cila për qëllim ka t'i krahasojnë analizat dhe rezultatet e ndryshme, që më në fund të mund të arrihet deri te njohuritë më solide të procesit të zhvillimit të gjuhës gjermane si në rrafshin diakronik edhe në atë sinkronik.

Punimi është i strukturuar në këtë mënyrë:

Ai ka gjashtë kapituj, përfundimin dhe shtojcën, në të cilën janë rimarrë tri intervista, që ndërlidhen me punimin në fjalë.

Në **kreun e parë** jepen qëllimet e punimet, përvijohet korniza teorike dhe korpusi, si dhe sqarohet metodologjia e punës.

Kreu i dytë tematizon foljen si njësinë qendrore tekstore-diskursive në gjuhën gjermane, duke e krahasuar atë me gjuhën shqipe në rrafshin e formimit dhe funksionit. Në të trajtohen perspektivat mbi foljen: gramatikore, sintaksore, semantike dhe pragmatike, si dhe postulatet gërshtetuese të këtyre perspektivave, duke iu referuar gjuhëtarëve si van Dijk, Frege, Dummet, etj.

Kreu i tretë i përkushtohet klasifikimit të foljeve sipas kritereve morfologjike, sintaksore dhe semantike, duke i analizuar dallimet me gjuhën shqipe në rrafshin paradigmatic e sintagmatic, si: në ndërtimin e kohëve të folës, mënyrat, por edhe sa u përket veçantive në të dyja gjuhët, me qëllim të kuptimit të nocionit „folje“ si pjesë e ligjëratës dhe si njësi bazë tekstore-diskursive.

Kreu i katërt tematizon fushën e fjalëformimit të foljes në gjermanishte, si një veçanti të rëndësishme leksikore të kësaj gjuhe, format e ndërtimit të kompozicioneve dhe derivacioneve, duke u fokusuar në formimin foljor me anë të parashtesave me bazë parafjalore dhe mundësitë e rimarrjes së tyre tekstore-diskursive në shqipe.

Kreu i pestë paraqet pjesën empirike të këtij disertacioni të doktoraturës, duke i analizuar veç e veç të gjitha parashtesat foljore me bazë parafjalore në gjermanishte, krahasuar me mundësitë e realizimit tekstor-diskursiv në gjuhën shqipe dhe duke nxjerrë në pah, në radhë të parë problemet e këtij procesi aq të ndërlikuar gjuhësor gjatë rimarrjes nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe.

Kreu i gjashtë është vetë fjalorthi i parashtesave foljore me bazë parafjalore, të cilat gjejnë përdorim më të dendur në mësimin e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj (DaF). Me këtë rast janë përfshirë rreth 1000 shembuj gjermanisht-shqip.

Kandidati Faik Idrizi ka përdorur një literaturë të dendur shkencore. Boshtin e kësaj teze doktore e përbëjnë gramatikat e ndryshme të gjuhës gjermane si DUDEN 4, Helbig/Buscha: Deutsche Grammatik fuer Auslaender, Harald Weinrich: Textgrammatik der deutschen Sprache, etj.

Për gjuhën shqipe janë shqyrtuar kryesisht Gramatika I dhe II e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe autorë të tjerë që merren me gjuhësinë krahasuese: si Arbër Çeliku, Brikena Kadzadej, etj.

Sa i përket korpusit, kryesisht është shfrytëzuar versioni on-line i databazës: www.duden.de dhe platforma: www.dwds.de, që përfshijnë një përmbledhje shembujsh nga letërsia gjermane, të folurit e përditshëm, artikuj gazetash, etj. Përkthimi i inventarit të shembujve realizuar nga ana ime, në konsultim edhe me udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Arbër Çeliku, i cili tashmë është i dëshmuar në fushën e përkthimit gjermanisht-shqip dhe anasjelltas.

P Ë R F U N D I M

Duke marr parasysh të gjithë këto parametra, ne, në cilësinë e komisionit vlerësues, konstatojmë se punimi i doktoraturës me temë: *Foljet me parashtesë të gjermanishtes (Präfixverben) dhe mundësitë e realizimit të tyre tekstor në gjuhën shqipe*, i kandidatit Faik Idrizi i plotëson të gjitha kriteret e duhura hulumtuese-shkencore.

Rezultatet e arritura janë të kënaqshme dhe sjellin risi të dukshme në korpusin e tërësishëm shkencor lidhur me fjalëformimin e foljeve me parashtesë në gjermanishte dhe shqipe dhe punimi i pasuron shkencat albanologjike me një punë serioze, e cila sjell prurje të reja.

Prandaj dhe njëzëri japim **vlerësimin tonë pozitiv** lidhur me punimin e doktoraturës në fjalë.


PROPOZIM

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit, ne e falënderojmë Këshillin Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik për besimin e dhënë për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatit Faik Idrizi me temë: *Foljet me parashtesë të gjermanishtes (Präfixverben) dhe mundësitë e realizimit të tyre tekstor në gjuhën shqipe* dhe njëzëri i propozojmë Këshillit Mësimor-Shkencor respektiv, që ta miratojë vlerësimin tonë pozitiv lidhur me këtë punim doktore dhe të vazhdojë me procedurën e mëtejshme deri në mbrojtjen publike të këtij punimi të doktoraturës.


Tetovë, më 12.06.2024

Komisioni vlerësues


1. Prof. Dr. Gjulfano Iseini – kryetar




2. Prof. Dr. Suzana Ejupi – anëtar



3. Prof. Dr. Arbër Çeliku – anëtar



4. Prof. Dr. Berton Sulejmani - anëtar



5. Doc. Dr. Shadan Ramadani – anëtar